Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës.....nuk lejohen
Përmbajtja e pesdicideve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standardeve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo llojë fruti dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore ose rrjeta ushqimore të lidhura të qepura ose të ngjitura në grykë të cilat të mbushen me fruta vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe kosistenca e frutave.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohet:

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilësia
- Masa neto e bruto

Transporti i perimeve, të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Specifikime teknike për artikullin

“MANDARINA”

Lloji: Mandarina per treg.

Kërkesat cilësore : Pamja e jashtme: të fresket, me zhvillim normal ,të shendoshe dhe me bisht . Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 %.Me pjekuri teknike të plote. Ngjyra,shija dhe aroma . Ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të embel ne të athet, pa shije të hidhur. Demtime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen. Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen. Lëndë të huaja nuk lejohen. Gervishtje ne sipërfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen. Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të sipërfaqes se tyre nuk lejohen. Të prekura nga oleooza lejohen 2 - 3 njolla per kokerr.

Permbajtja e pesdiciteteve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivareve ne arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike ne fuqi per cdo lloj fruti dhe të pastra. Frutat mund të ambalazhohen edhe ne qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, te qepura ose të ngjitura ne gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen ne arka ne menyre të tille, të cilat të ruhet freskia dhe kosistenca e frutave. Mbi cdo ambalazh vendoset etiketa ku shenohet: Firma prodhuese. Lloji i prodhimit. Cilesia. Masa neto e bruto. Transporti i frutave të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

Specifikime teknike për artikullin

“BANANE”

Kërkohen , të freskëta , me zhvillim normal , në tufë , me pjekuri teknike të plotë.

- Ngjyra të jetë jeshile në të verdhë, me erë dhe aromë te këndshme, karekteristike e këtij kultivari.
- Madhësia e kokrrës të jete mesatare.
- Dëmtime mekanike nuk lejohen.

- Njolla të kafta që tregojnë tejkalimin e pjekurisë nuk lejohen.
- Gervishtje të lekurës nuk lejohen.
- Zbutje të lekurës nuk lejohen.

Ambalazhimi të jetë në kuti kartoni standarde tipike për tregëtimin e bananes.

...

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR QUMËSHT E PRODUKTE QUMËSHTI

Për qumështin dhe produkte të tij operatorët ekonomik duhet të operojnë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore, kushtet që duhet të plotësojnë ushqimet me origjinë shtazore dhe jo shtazore të cilat përcaktohen dhe sipas Dokumentit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit i datës 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” dhe shtojcës 1, bashkëlidhur këtij rekomandimi.

Specifikime teknike për artikullin

”QUMËSHT PËR KONSUM, I FRESKËT”

Kërkesat cilësore:

- Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.
- Gjatë përpunimit dhe tregëtimit të zbatohen rregullat higjieno sanitare e veterinare në fuqi.
- Nuk duhet të lejohet përdorimi i lëndëve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.
- Të plotësojë treguesit organo-lepitkë dhe ato fiziko-kimike.
- Pamja e jashtme:
 - Të jetë lëng homogjen, pa lëndë të huaja që notojnë apo precipitojnë.
 - Ngjyra e bardhë e njëllotë, nuancë e lehtë e verdhë .
- Shija dhe era të këndshme, lehtësisht e ëmbël, shije e lehtë zierjeje, pa shije ose erëra të huaja.

1. Treguesit fiziko-kimike:

2. Dendësia në 20 gradë celsius- jo më pak se 1.029 gram/ml.

-Yndyra jo më shumë se 2 %.

-Aciditeti në gradë Tjoneer.: jo më shumë se 20 (periudha 1 Tetor-31 Mars) jo më shumë se 21 (Prill -30 Tetor).

-Lëndë të thata (pa yndyra) jo më pak se 8.5 %.

-Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes) duhet negative.

-Pastërtia pa mbetje me site mëndafshi apo merle pambuku dyfishe.

-Ambalazhimi brenda kushteve higjieno-sanitare, në kuti Tetra-Pack, me peshe një litër ku të jenë vendosur:

- Marketimi: Emërtimi i prodhuesit.
- Emri i produktit .
- Pesha neto ose vëllimi i produktit.
- Data e prodhimit .
- Data e skadimit.

- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

-Ngarkesa mikrobike sipas normave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

-Rruajtja e transportimi në temperaturë 2 deri në 8 gradë celsius.

Specifikime teknike për artikullin

1.

“DJATHË”

Bazuar në STAZH...1410 \87, ose ekuivalentin e tij.

2. **Lloji:** Djathë fete
3. **Ngjyra:** E bardhë
4. **Forma:** Prizëm, trekëndësh me një faqe anësore cilindrike.
5. Masa e formës në g, 2-3 kg.
6. **Era dhe shija:** E këndshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije e erë të huaj .
7. **Pamja e jashtme dhe e brendshme:** E formuar mirë, e pastër dhe pa njolla.
8. Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe.
9. Në prerje është e njëllotë e pastër pa lëndë të huaja me sythe teknikë, me ngjyrë të bardhë deri në krem.
10. **Struktura dhe konsistenca:** E lëmuar jo e fortë dhe pa dallim shtresash.
11. Treguesit fiziko kimikë:

1-Lagështira në % , jo më shumë se

- Për periudhën1.05- 30.09, jo më shumë se 52 %
- Për periudhën..... 1.10.- 30.04, jo më shumë se 56 %

2- Lëndët e thata jo më pak se

- Për periudhën..... 1.05- 30.09, jo më pak se 48 %
- Për periudhën1.10.- 30.04, jo më pak se 44 %

3-Yndyra në lëndët e thata,jo më pak se 50 %

4-Kripë deri 4 ±1%

5-Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi: Në voza plastike me vëllim 50 l.

Djathi në vozë qëndron i mbuluar me shëllirën fillestare e cila përmban 10 – 14 % kripë deti.

Mbi çdo ambalazh me djathë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.
- Malli të shoqërohet me raport analize laboratorike.

Ruajtja dhe transportimi: Djathërat e butë ruhen në frigorifer në temperaturë 3-5 °C, dhe lagështi relative të ajrit rreth 95%. Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 12 muaj.

Transportimi i djathërave të butë nga një rreth në tjetrin bëhet me mjete frigoriferike. Ndërsa brenda rrethit lejohet transportimi i tyre me mjete të zakonshme të mbuluara e të pastra të cilat janë të destinuara për transportimin e prodhimeve ushqimore.

Specifikime teknike për artikullin

“GJALPË I FRESKËT”

Bazuar në SSH ISO 1445:1987 Ose ekuivalent

Lloji: Gjalpë i freskët dhe me kripë

Pamja: E njëtrajtshme pa shtresa në prerje me sipërfaqe të shndritur pa pika uji dhe mbeturina dhalli .

Ngjyra :

- Gjalpi i freskët ngjyra, krem deri në të verdhë të çelur.
- Gjalpi i kripur ngjyra e bardhe deri në të verdhë, karakteristikë e kremit nga e cila prodhohet e njëllotë në të gjithë masën.
-

Konsistenca në temperaturën 10 – 12 °C, gjysmë e fortë.

Era dhe shija :

- Gjalpi i freskët, e këndshme karakteristikë e gjalpës të freskët, pa erë dhe shije të huaj.
- Gjalpi i kripur, era e këndshme, karakteristikë e gjalpës, lehtësisht e kripur, pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

12. Lagështira në % ,jo më shumë se.....17 %
13. Lëndët e thatë pa yndyrë në %, jo më shumë se 2 %.
14. Yndyra në %, jo më pak se 81 %, gjalpi i freskët dhe 79 % gjalpi i kripur.
15. Kripë në % jo më shumë se 2 %gjalpi i kripur
16. Aciditeti i shprehur në g Ketshtofer jo më shumë se 3 % gjalpi i freskët dhe..... 5 gjalpi i kripur.
17. Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi: Gjalpi i freskët dhe i kripur ambalazhohet në kuti kartoni të valëzuar me masë 1- 5 kg, të veshur nga brenda me letër pergamen.

Mbi çdo ambalazh me djathë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës origjinale.
- Malli të shoqërohet me raport analize laboratorike.

Ruajtja dhe transportimi: Gjalpi ruhet në frigorifer në temperaturë 2-4 °C,

Transportimi i gjalpit nga një rreth në tjetrin bëhet me mjete frigoriferike. Ndërsa brenda rrethit lejohet transportimi i tyre me mjete të zakonshme të mbuluara e të pastra të cilat janë të destinuara për transportimin e prodhimeve ushqimore.

Kërkesa të tjera

1. Operatori ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjedisit, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
2. Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe në respektim të standardeve të kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, konform manualit të vetëkontrollit HACCP.
3. Transporti i ushqimit të përgatitur nga kuzhina e shërbimit të ushqimit social për grupet e veçanta deri te konsumatori, të realizohet me mjete, pajisje dhe enë të posaçme (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasisë që ofrohet, si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit të produktit).

-
4. Operatori ekonomik, të respektojë rregullat e higjienës për larjen, pastrimin, dhe përpunimin e zarzavateve, frutave, sipas kërkesave të ligjeve në fuqi në fushën e higjienës dhe ushqimit.
 5. Operatori ekonomik duhet të sigurojë një higjiene të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhinës, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit dhe mensave. Aktualisht në fuqi është Urdhri nr. 365 datë 03.08.2012 i Ministrit të Shëndetësisë “Për miratimin e listës dhe përdorimin e lëndëve që përdoren për dezinfektim, deratizim, desinsektim në shëndet publik”.
 6. Operatori ekonomik duhet të realizojë larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren. Pastrimi i inventarit të imët kryhet nga operatori ekonomik, i cili duhet të mbajë dhe regjistrat e pastrimit.
 7. Në rast të sëmundjeve infektive, të përdoren për shpërndarje të ushqimit vetëm pajisje të veçanta dhe njëpërdorimshme.
 8. Operatori ekonomik, do të paketojë dhe të evadojë çdo ditë mbeturinat që krijohen si rezultat i prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit, në vëndet e caktuara si vend grumbullimi mbeturinash. Sqarojmë se vendi I grumbullimit të mbeturinave është Brenda ambienteve të Njesisë.
 - 10 Materiali në kontakt me ushqimin (termuset, enet, etj, me të cilat transportohet ushqimi) të jenë material i përshtatshëm dhe lehtësisht të pastrueshme, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 22, datë 25.11.2010 “Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”, me mbyllje hermetike (për të siguruar mbrojtjen nga mjedisi i jashtëm). Enët që përdoren për transportin dhe/ose shpërndarjen e ushqimit duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin.
 - 11 Punonjësit e operatorit ekonomik në momentin e përgatitjes/shërbimit të ushqimit në ambientet e autoritetit kontraktor, duhet të jenë të pajisur me uniformën, veshjen përkatëse të punës (përparëse, grykëse, këpuce, pantallona, këpuce), këta të fundit të jenë të pajisur me librezë shëndetësore.
 - 12 Operatori ekonomik duhet që në çdo kohë të shoqëroje ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjet gjurmueshmërisë së tij, sipas VKM nr. 760, datë 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor” dhe analizave të ujit që përdor.
 - 13 Operatori ekonomik është i detyruar të ruajë në rafte të veçanta në mjedisin e kuzhinës, kampionet e ushqimit të gatuar e që shpërndahet për ngrënie për të gjitha vaktet. Afati i ruajtjes së mostrave (kampionëve) është 24-orë. Kur ka denoncime për cilësinë e ushqimit, ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.
 - 14 Operatori ekonomik, do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të mostrave të ushqimit gatuar, sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor.

III. PROGRAMI USHQIMOR

1. Kërkesa për gatimin dhe përgatitjen e ushqimit

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimin e ushqimit sipas normave dhe atyre të zëvendësimit të paraqitura në dokumentet e tenderit. Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimore sipas sasisë e kalorive përkatëse të miratuara.

Nuk lejohet në asnjë rast dhe për asnjë arsye zëvendësimi nga operatori ekonomik i artikujve ushqimorë që janë të përcaktuara në normën bazë të ushqimit dhe menunë javore të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menusë javore të ushqimit të miratuar nga Shefi I i Njesisë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, konformë normave bazë të ushqimit.

Menuja e ushqimit do të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura sipas normave bazë të ushqimit

2. Programi Ushqimor

Llojshmëria e ushqimit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara nga programi dhe menuja e përgatitur nga shërbimi i ushqimit dhe i shëndetësisë të Njesisë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA” në bazë të normave.

Ky program ushqimor do të ketë dhe konfirmimin e sipërmarrësit. Sipërmarrësi do të zbatojë planin e menusë ditore dhe javore të ushqimit sipas programit të miratuar nga Njësia.

Programi ushqimor do të jetë i veçantë për të dy rastet. Për vaktin drekë sipas normës së vaktit drekë, për tre vakte sipas normës ushqimore të Forcave Speciale si dhe për kursantët sipas normës për kursantë.

Programi ushqimor do të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura. Sasia dhe cilësia e ushqimeve që furnizohen nga sipërmarrësi duhet të përgjigjen kushteve që përcakton Ligji “Për Ushqimin”.

3. Servirja e ushqimit

Shpërndarja e ushqimit do të bëhet nga operatori ekonomik me pajisjet e tij në mensën e Njesisë dhe në rastet e daljes së efektivave jashtë repartit, servirja do të bëhet nga operatori ekonomik atje ku ato janë dislokuar.

Shpërndarja e ushqimit do të realizohet me vetëshërbim. Personeli sipas orarit të ngrënies së ushqimit do të shkojë i lirë në mensë dhe do të shërbehet konformë rregullave e standardeve të kërkuara.

Servirja e ushqimit do të bëhet në banakë inoksi. Ushqimi i servirur do të jete gjithmonë i ngrohtë brenda orarit të ngrënies së ushqimit.

4. Orari i konsumit të ushqimit:

Shpërndarja e ushqimit do të bëhet kundrejt bonove ditore të përgatitura nga operatori kontratues.

Shpërndarja dhe ngrënia e ushqimit do të bëhet në oraret e mëposhteme.

MENGJESI	-	Ora 08:00 – 09:00
DREKA	-	Ora 13.00 - 14.30
DARKA	-	Ora 18.30 - 19.30

Operatori ekonomik do të sigurojë personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të siguruar në kohe dhe për të kryer servirjen e shpejtë dhe me kulturë të ushqimit.

Te sigurojë vendin dhe sasinë e mjaftueshme dhe të shumëllojshme me pjata porcelani, tabaka për marrjen e ushqimit e mjeteve të tjera të nevojshme për ngrënien e ushqimit nga personeli.

Mensa në mënyrë permanente të jetë e kompletuar nga operatori ekonomik me mbulesa tavolinash (letre), complete servirje inoksi për çdo 4 veta me vaj ulliri, uthull, kripë, erëza e kruajtëse dhëmbësh; me gota uji për çdo person dhe kane uji për çdo 4 veta; me lugë, pirunj e thika inoksi; me mbajtëse frutash e buke për çdo 4 veta si dhe kartepeceta për çdo person.

Në dalje të mensave të jenë të vendosur në mënyrë permanente karrocet portative për vendosjen e tabakave të servirjes pas ngrënies së ushqimit nga personeli.

5. Kërkesa higjeno-sanitare

Operatori ekonomik duhet të garantojë e sigurojë ushqim të freskët dhe të mbrojtur nga kontaminimet.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit sipas ligjit mbi inspektoriatin sanitar.

Operatori ekonomik të sigurojë një ambient me temperaturën që përcaktohet në standartin ISO, për ruajtjen dhe mbrojtjen e ushqimeve si dhe një sistem ajrimi edhe temperaturë normale në mense dhe në kuzhinë.

Operatori ekonomik të sigurojë detergjentë në vendet e larjes së duarve me ujë të ngrohtë e të ftohtë dhe mjete për tharjen e tyre.

Operatori ekonomik të respektojë rregullat e higjienës për larjen, pastrimin dhe përpunimin e zarzavateve, frutave etj.

Personeli i kuzhinës dhe shpërndarjes së ushqimit duhet të jenë kontrolluar për gjendjen shëndetësore dhe higjienike, duke i pajisur me librezën përkatëse shëndetësore nga inspektoriat i higjienës. Rifreskimi i librezave shëndetësore të bëhet çdo 6 muaj.

Personeli i shërbimit të ketë uniformë pune me stampën e logos së operatorit ekonomik.

Operatori ekonomik është i detyruar të transportojë e depozitojë mbeturinat të ambalazhuara, në vendin e depozitimit të tyre të përcaktuar nga Bashkia ose Njësia administrative. Vendi i grumbullimit të mbeturinave është brenda Njesisë.

6. Kërkesa të organizimit e manaxhimit të ushqimit (kontrolli dhe forca ditore)

Forca ditore e ushqimit sipas rastit do të përbëhet nga:

- numri i punonjësve të policisë që trajtohen me një vakt, me vaktin drekë
- numri i punonjësve që trajtohen me normën e Forcave Speciale me tre vakte

Te drejtën e ndryshimit të orarit për shpërndarjen e ushqimit e ka titullari i autoritetit kontraktor ndërsa sipërmarrësi të respektojë orarin e përcaktuar.

Çdo ditë operatori ekonomik të dokumentojë sasinë e ushqimit të përgatitur dhe konsumuar me fletë-dalje, të cilën bashkë me raportin e situatës ditore, të cilat do të dorëzohen në financën e Autoritetit Kontraktor për likuidim.

Produktet ushqimore dhe ushqimi i gatuar nga operatori ekonomik do t'i nënshtrohet kontrolleve nga Autoriteti Kontraktor duke ju referuar specifikimeve teknike të tyre për cilësinë, sasinë dhe normën sipas menisë javore.

Autoriteti Kontraktor është i detyruar të ruajë në kushte frigoriferike në mjedisin e kuzhinës kampionet e ushqimit të gatuar sipas rastit për një ose tre vaktet. Afati i ruajtjes së kampioneve është 24 orë dhe vulohet nga mjeku i njësisë dhe oficeri i rojes. Kur ka ankesa për cilësinë e ushqimit ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.

Operatori ekonomik me anë të strukturave përkatëse do të rakordojë me Autoritetin Kontraktor çdo muaj për racione ditore të porositura sipas normave përkatëse, të bazuara në raport-situatat e lëshuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe pasqyrës përmbledhëse mujore.

Likuidimi i vlerës së ushqimit të gatuar do të kryhet në fund të çdo muaji në bazë të forcës ditore të porositur, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës të konsumit ditor gjatë gjithë muajit të përcaktuar në kontratë, sipas akt-rakordimit mujor të firmosur nga të dy palët në sasi dhe vlerë.

Ushqimi i gatuar duhet të shpërndahet nga operatori ekonomik pasi të jetë kontrolluar dhe firmosur për çdo vakt nga një përfaqësues të autoritetit kontraktor në librin e kontrollit të ushqimit, i cili qëndron pranë kuzhinës dhe ruhet nga Autoriteti Kontraktor në të njëjtin vend me kampionet e ushqimit.

7. Ambientet dhe vendet e punës .

Ambientet duhet të plotësojnë normat higjieno sanitare, kushtet teknike nga ana ndërtimore, si dhe impiantet elektrike, hidraulike, gazi dhe shkarkimet e ujërave të cilat do të vihen në funksionim për përdorim nga sipërmarrësi, brenda normave teknike dhe afatit të përcaktuar nga palët. Këto ambiente do të mirëmbahen nga sipërmarrësi deri në përfundimin e afatit të kontratës.

Kontraktuesi të marrë përsipër të kryejë riparimin e ambienteve të kuzhinës dhe mences sa here që lind e nevojshme për të kryer riparime e përmirësime të kushteve.

Riparimet e bera në fakt do të pasqyrohet me preventivat dhe situacionet përkatëse dhe përballohet nga kontraktuesi (sipërmarrësi). Këto preventiva do të miratohen nga Titullari i Autoritetit kontraktor dhe do të jenë pjesë e kontratës.

8. Inventari i imët për ndarjen e ushqimit

Për realizimin e këtij shërbimi operatori ekonomik që do të shpallet fitues, në ditën e fillimit të kryerjes së shërbimit duhet të ketë në dispozicion në vendin e realizimit të shërbimit, të gjitha mjetet e pajisjet e nevojshme bashkëkohore për realizimin e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit duke mos u kufizuar vetëm në: (Njësia Speciale Delta”)

Pajisjet e kuzhinës

Nr.	Emërtimi i pajisjeve	Njësi e matjes	Sasia
1	Tigan i madh	copë	2
2	Qërues Patatesh	copë	1
3	Grirëse Zarzavatesh	copë	1
4	Makinë grirëse mishi	copë	1
5	Frulator Mikser	copë	1
6	Rrahëse vezësh	copë	1
7	Fritez me gaz/eklektike	copë	1

8	Karroca shërbimi	copë	2
9	Karroca transporti	copë	2
10	Tava shërbimi e gatimi	copë	10
11	Banak shërbimi ngrohës	copë	1
12	Banak shërbimi ftohës	copë	1
13	Banak neutro	copë	1
14	Mbajtës lugësh, pirunësh, tabakash	copë	1
15	Frigorfer	copë	2
16	Dhome Frigoriferike	copë	1
17	Bolier	copë	2
18	Lavastovilje industrial	copë	1
19	Makine grirëse mishi	copë	1
20	Makine prerëse buke	copë	1
21	Peshore elektronike 30kg	copë	1
22	Soba gatimi me gaz deri 300 racione	copë	1

Tabela e inventarit ekonomik për ndarjen e ushqimit

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i pajisjeve</i>	<i>Njësi e matjes</i>	<i>Sasia</i>
1	Pjata gjelle porcelain	copë	120
2	Pjata sallate	copë	80
3	Lugë gjelle inoksi	copë	60
4	Pirunë inoksi	copë	60
5	Çajnik	copë	10
6	Gota Çaji	copë	50
7	Filxhan qumështi porcelani	copë	50
8	Tabaka plastike	copë	50
9	Set servisi (vaj, kripe, uthull etj)	copë	10
10	Thika buke inoksi	copë	30
11	Thika frutash inoksi	copë	30
12	Shporta buke	copë	15
13	Shporta frutash	copë	15
14	Kazan 200 Rac. Inoksi	copë	1
15	Kazan 100 Rac. Inoksi	copë	2
16	Kazan 50 Rac. Inoksi	copë	4
17	Tenxhere 30 Rac. Inoksi	copë	3
18	Tenxhere 20 Rac. Inoksi	copë	3
19	Garuzhde 1 Rac. Inoksi	copë	3
20	Garuzhde 5 Rac. Inoksi	copë	3
21	Kulluese makaronash inoksi	copë	2
22	Kosha mbeturinash	copë	3
23	Kosha mbeturinash të mëdhenj	copë	2
24	Hanxhar mishi	copë	2
25	Gota uji qelqi	copë	60

26	Kanë uji qelqi	copë	10
27	Tava të mëdha inoksi 30 – 50 Rac	copë	3
28	Tava të vogla inoksi 20 – 30 Rac	copë	3
29	Lopata të sheshta	copë	2

9. Norma e artikujve ushqimore për një Racion ditor të Forcave Speciale sipas Udhëzimit të përbashkët Ministrit të Brendshëm & Ministrit të Shëndetësisë nr 942 date 03.10.2017 (Pasqyra 2 dhe 14).

10.

• **Norma me 3(tre) Vakte**

Nr .	Ushqimet	Sasia gr pjese e plote ushqimi /rritja ne % Pasqyra Nr 14 Udhëzim MB& MSH nr 942 date 03.10.2017 . /ne gr	Energji k/kalori
1	Bukë gruri masive	450	1102,5
2	Oriz	60	217.2
3	Makarona	60	213.6
4	Fasule	50	155.5
5	Mish viçi	378	388.8
6	Vaj ushqimor	40	360
7	Gjalpë i freskët	40	303.2
8	Sheqer	50	196
9	Sallam	50	227
10	Djathë i bardhë	100	250
11	Qumësht	500	245
12	Vezë (2 kokrra mesatare)	120	187.2
13	Patate	234	170
14	Perime për gatim + sallatë	517.5	85.5
15	Fruta	549	202.5
16	Reçel	30	62.7
17	Salcë domate	10	5
18	Çaj mali	4	4.32
19	Kripë	10	0
20	Erëza	3	1.98
21	Miell tip 00	20	51.45
22	Çokollata	40	226
	Totali		4655.4

			5
--	--	--	---

• **Norma me 1 vakt (dreka)**

Nr.	Ushqimet	Sasia ne gr	Energji k/kalori
1	Bukë gruri massive	150	367.5
2	Oriz	0	0
3	Makarona	60	213.6
4	Mish viçi	378	388.8
5	Vaj ushqimor	17	153
6	Gjalpë i freskët	20	151.6
7	Sheqer	40	156.8
8	Qumësht	100	49
9	Vezë (2 kokrra mesatare)	60	46.8
10	Perime për gatim + sallatë	517.5	85.5
11	Fruta	549	202.5
12	Salcë domate	5	2.5
13	Kripë	3	0
14	Erëza	2	1.32
15	Miell tip 00	15	51.45
	Totali		1870.37

• **Norma per kursantet**

Nr .	Ushqimet	Sasia gr pjese e plote ushqimi /rritja ne % Pasqyra Nr 14 Udhezim MB& MSH nr 942 date 03.10.2017 . /ne gr	Energji k/kalori
1	Bukë gruri masive	450	1102,5
2	Oriz	60	217.2
3	Makarona	60	213.6
4	Fasule	50	155.5
5	Mish viçi	280	288
6	Vaj ushqimor	40	360
7	Gjalpë i freskët	30	227.4
8	Sheqer	40	156.8
9	Sallam	50	227
10	Djathë i bardhë	100	250
11	Qumësht	400	196

12	Vezë (2 kokrra mesatare)	120	187.2
13	Patate	234	170
14	Perime për gatim + sallatë	517.5	85.5
15	Fruta	488	180
16	Reçel	30	62.7
17	Salcë domate	6	3
18	Çaj mali	3	3.24
19	Kripë	5	0
20	Erëza	3	1.98
21	Miell tip 00	15	51.45
	Totali		4,139.07

Normat e zëvendësimit

Tabela: Ekuivalentet ushqimore sipas nëngrupeve ushqimore me origjinë të njëjte

Nr.	Grupi i ushqimeve	Ekuivalentet ushqimore
1.	Qumësht dhe nënprodukte të tij	
	125 gr qumësht =	125 gr kos
		100gr djathë të bardhë
		50 gr djathë kackavall
2.	Mish peshk dhe vezë	
	100 gr mish viçi/derri/lope etj =	100 gr mish të bardhë (pule, gjeli, lepur)
		50 gr sallam
		150 gr peshk /fruta deti (të freskëta ose të ngrira)
		50 gr konservë peshku
		50 gr vezë
3.	Bishtajoret	
	150 gr bishtajore të freskëta (mashurka, bizele)=	50 gr fasule e thatë
		50 gr thierza
4.	Drithërat dhe nënproduktet e tyre	
	50 gr bukë =	80 gr oriz
		80 gr makarona
		80 gr misër
		50 gr kroasan/ kek, etj
		30 gr drithëra për mëngjes (cornflax/ musli/)
		200 gr patate

5.	Frutat	
	150 gr fruta të freskëta =	30 gr fruta të thata (arra, bajame, kikirikë, etj)
		30 fruta të thata sheqerosura
6.	Yndyrat	
	10 ml vaj ulliri ose farërash (misri. Luledielli) =	10 gr gjalpë

Zëvendësimi i artikujve të mësipërm përdoren vetëm në rastet kur merret miratim nga titullarit të Autoritetit Kontraktor.

IV. Sasia e 1 Racioni ditor me 3 (tre) Vakte

Nr.	Ushqimet	Sasia /KG	Çmimi pa tvsh	Vlera pa tvsh
1	Bukë gruri masive	0.450		
2	Oriz	0.060		
3	Makarona	0.060		
4	Fasule	0.050		
5	Mish viçi	0.378		
6	Vaj ushqimor	0.040		
7	Gjarpë i freskët	0.040		
8	Sheqer	0.050		
9	Sallam	0.050		
10	Djathë i bardhë	0.100		
11	Qumësht	0.500		
12	Vezë (2 kokrra mesatare)	0.120		
13	Patate	0.234		
14	Perime për gatim + sallatë	0.5175		
15	Fruta	0.549		
16	Reçel	0.030		
17	Salcë domate	0.01		
18	Çaj mali	0.004		
19	Kripë	0.01		
20	Erëza	0.003		
21	Miell tip 00	0.020		
22	Çokollata	0.040		
	Vlera për 1nje RD pa tvsh			

Sasia e 1 Racioni ditor me 1(një) Vakt (dreka)

Nr.	Ushqimet	Sasia ne gr	Çmimi pa tvsh	Vlera pa tvsh
1	Bukë gruri masive	0.150		
2	Oriz			
3	Makarona	0.060		
4	Mish viçi	0.378		
5	Vaj ushqimor	0.017		
6	Gjalpë i freskët	0.020		
7	Sheqer	0.040		
8	Qumësht	0.100		
9	Vezë (2 kokrra mesatare)	0.050		
10	Patate	0.100		
11	Perime për gatim + sallatë	0.5175		
12	Fruta	0.549		
13	Salcë domate	0.005		
14	Kripë	0.003		
15	Erëza	0.002		
16	Miell tip 00	0.015		
	Vlera per 1nje RD pa tvsh			

IV. Sasia e 1 Racioni ditor me 3 (tre) vakte kursantet

Nr.	Ushqimet	Sasia /KG	Çmimi pa tvsh	Vlera pa tvsh
1	Bukë gruri masive	0.450		
2	Oriz	0.060		
3	Makarona	0.060		
4	Fasule	0.050		
5	Mish viçi	0.280		
6	Vaj ushqimor	0.040		
7	Gjalpë i freskët	0.030		
8	Sheqer	0.040		
9	Sallam	0.050		
10	Djathë i bardhë	0.100		
11	Qumësht	0.400		
12	Vezë (2 kokrra mesatare)	0.120		
13	Patate	0.234		
14	Perime për gatim + sallatë	0.5175		
15	Fruta	0.488		
16	Reçel	0.030		

17	Salcë domate	0.006		
18	Çaj mali	0.003		
19	Kripë	0.005		
20	Erëza	0.003		
21	Miell tip 00	0.015		
	Vlera për 1nje RD pa tvsh			

V. KËRKESAT PËR PERSONELIN KRYESOR :

- Operatori ekonomik fitues duhet te siguroje punonjës te kualifikuar dhe me eksperience pune.
- Operatori ekonomik merr përsipër kontrata të rregullta pune për personelin e shërbimit duke kryer pagesat e sigurimeve shoqërore.
- Të gjithë punonjësit e operatorit ekonomik duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me shenja dalluese përkatëse të shoqërisë.
- Operatori ekonomik duhet t'i kompletoj të gjitha mjetet dhe pajisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë.
- Operatori ekonomik do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktor konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme ose është mjaft i pakënaqur nga puna e këtij personi.
- Punonjësit gjatë kohës se punës ne ambientet e repartit duhet të zbatojnë me korrektësi rregullat e qëndrimit ne pune dhe hyrjes e daljes nga institucioni policor.
- Personeli do të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shëndetësor.

Përshkrimi i shërbimeve:

Furnizimi i lendes se pare, përgatitja, gatimi dhe shpërndarja e ushqimit për një vakt dhe tre vakte ne ambientet e Njesisë Speciale për Kufirin dhe Migracionin DELTA, sipas programit ushqimor javor dhe ditor të përgatitur dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Objektivat :

- Te siguroje furnizimin ne kohe dhe me cilësinë e kërkuar te ushqimit te gatuar.
- Te garantoje ne çdo koheshumëllojshmërinë dhe kaloritë e nevojshme sipas normës për punonjësit e policisë.
- Te siguroje ushqim te sigurte për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet qe mund te shkaktohen nga ushqimi.
- Të bëjë kompletimin e ambienteve (mense e kuzhine) me pajisjet e domosdoshme për furnizimin, përgatitjen, gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit.
- Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit në rastet e daljes së efektivit në terren.
- Te siguroje kushtet e nevojshme hijeno sanitare për realizimin e shërbimit.
- Te siguroje shërbim me standarde te larta.

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*Loti 1: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike, Tiranë”**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike, Tiranë”**Afatet e ekzekutimit:**

Shërbimi	Përshkrimi	Shuma totale e racioneve & vakteve		Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike, Tiranë	Sipas specifikimeve teknike			Sipas specifikimeve teknike	Sipas nevojave të AK, brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
		Vakti Dreke	31,389		
		Norma 3 (tre) vakte	32,850		

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Vlorë”

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Realizimi i shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit do të bëhet në ambientet e Njësisë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA” Radhimë, Vlorë, dhe në vend dislokimet e përkohshme kur Njësia lëviz për stërvitje dhe shërbim.

Shërbimi	Përshkrimi	Shuma totale e racioneve & vakteve		Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Vlorë	Sipas specifikimeve teknike	Norma me 1 Vakt (Dreka)	18,720	Sipas specifikimeve teknike	Sipas nevojave të AK, brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
		Norma me 3 (tre) vakte	15,330		
		Norma e Kursanteve 3 (tre) vakte	1,080		

Afatet e ekzekutimit:

Afati i ekzekutimit të shërbimit është Sipas nevojave të AK, brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Loti 1: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike, Tiranë”

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike, Tiranë”

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Realizimi i shërbimit do të bëhet pranë Autoritetit Kontraktor, Njësia e Sigurisë Publike, Tiranë, sipas specifikimeve teknike.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Vlorë”

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Vlorë”

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Realizimi i shërbimit do të bëhet pranë Autoritetit Kontraktor, Njësia Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Vlorë”, sipas specifikimeve teknike.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Loti 1: "Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike, Tiranë"

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e

drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë.

2.1.3 Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë Aktin e kontrollit të fundit të realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ku ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SH EN ISO 22000 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 8 (tetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Kryekuzhinier	1(një)
2	Kuzhinier	1 (një)
3	Ndihmës Kuzhinier	1 (një)
4	Punonjës shpërndarës ushqimesh	2 (dy)
5	Sanitar/e	2 (dy)
6	Shofer	1 (një)
	Total	8 (tetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për 2 (dy) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Kryekuzhinierin, Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh dhe Sanitar/e.

Deklaratë se stafi i kërkuar nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

a) Për kryekuzhinierin

- Diplomë e arsimit të lartë ose të mesëm profesional si kuzhinier
- Kontratë pune si kryekuzhinier (e vlefshme)

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 5 pese vite.

b) Për kuzhinierin:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontrate pune si kuzhinier
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi dhe sanitaret të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi dhe sanitar/e (e vlefshme).

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik ofertues përveç dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 më sipër, për kryekuzhinierin dhe kuzhinierin duhet të dorëzojë edhe dokumentet përkatëse për secilin, në përputhje me kërkesën e përcaktuar në DST, "Njoftimi i kontratës", Seksioni 4: Procedura, pika 4.4, gërma A "Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", nënpika 2.1 dhe 2.2.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët.

2.3.7 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë se produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve janë në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, konform manualit të vetekontrollit HACCP.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësine Speciale për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Vlorë”

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

a) KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
